Në bazë të nenit 36, paragrafi (1), pika 11 të Ligjit të Kulturës ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 15/2008, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/2015, 39/2016 dhe 11/2018) dhe nenit 21, paragrafi (1), pika 11 të Statutit të Institucionit Nacional "Orkestra e Muzikës Xhaz" – Shkup, në mbledhjen e 14-të, të mbajtur më 1.4.2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MBAJTJEN E RIAUDICIONIT NË IN "ORKESTRA E MUZIKËS XHAZ" E RMV-së

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, mënyra dhe procedura për zbatimin e riaudicionit (vlerësimin e efektit çdo 3 vjet) të artistëve të kategorisë A në Orkestrën e Muzikës Xhaz.

Artistët e kategorisë A, të cilët kanë 10 (dhjetë) vite deri në realizimin e të drejtës për pension, janë të përjashtuar nga paragrafi 1 i këtij neni, përkatësisht efekti i tyre nuk vlerësohet nëpërmjet zbatimit të procedurës së riaudicionit.

Neni 2

Procedurën për realizimin e riaudicionit e zbaton komisioni i formuar nga drejtori.

Komisioni përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, artistë të shquar me nivel më të lartë profesional se niveli i kandidatit për të cilin zhvillohet procedura e riaudicionit.

Drejtori, në afat prej 5 (pesë) ditësh, miraton aktvendim në bazë të propozimit të komisionit, me të cilin përcaktohet nëse artisti e ka kaluar, përkatësisht nuk e ka kaluar riaudicionin.

Vlerësimi i efektit (riaudicioni)

Neni 3

Komisionet kryejnë riaudicionin për vlerësimin e efektit të artistëve të kategorisë A, sipas disa kritereve të përcaktuara nga ana e drejtorit.

Komisionet mund të përcaktojnë edhe kritere shtesë ndihmëse.

Neni 4

Para fillimit të riaudicionit, komisionit i dorëzohen formularët e përgatitur paraprakisht, në të cilët janë shënuar të dhënat personale të personit që vlerësohet, së bashku me kriteret e domosdoshme për verifikim.

Çdo anëtar i komisionit i shpreh rezultatet e verifikimit të secilit kriter me notë nga 1 (një) deri në 5 (pesë), për secilin artist veçmas.

Çdo artist (ofrues i shërbimit) e kalon riaudicionin nëse ka një notë mesatare ose më të lartë se 3 (tre).

Komisioni, me procesverbal të veçantë, i përmbledh rezultatet.

Procesverbalin me notat e riaudicionit, komisioni ia dorëzon drejtorit për secilin ofrues të shërbimit veçmas, brenda afatit prej 1 (një) dite, përkatësisht ditën e ardhshme të punës.

Neni 6

Artisti i cili e ka kaluar riaudicionin, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i riaudicionit, me aktvendim sistemohet në të njëjtin vend pune ose mund të sistemohet edhe në një vend pune më të lartë, në pajtim me Aktin e sistematizimit të vendeve të punës të IN Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së.

Artisti i cili nuk e ka kaluar riaudicionin, me aktvendim sistemohet në të njëjtin vend pune dhe është i obliguar që brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh të hyjë në riaudicion të ri.

Nëse edhe për herë të dytë nuk e kalon riaudicionin, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, artisti me aktvendim do të sistemohet në një vend pune më të ulët në institucion. Në rastin nga paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, për artistin i cili është sistemuar në një vend pune më të ulët, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajsh do të organizohet riaudicion i përsëritur.

Nëse edhe për herë të tretë (3) nuk e kalon riaudicionin, drejtori do të miratojë aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së artistit. Por, nëse e kalon riaudicionin e përmendur, drejtori me aktvendim e sistemon atë në vendin e punës ku ka qenë para zhvillimit të riaudicionit të parë.

Neni 7

Pas pranimit të aktvendimit për sistemimin nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, personi ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Këshillit drejtues.

Këshilli drejtues, brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh, vendos lidhur me ankesën e paraqitur.

Artisti i pakënaqur me vendimin e Këshillit drejtues mund të paraqesë padi pranë gjykatës kompetente.

Padia nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj dhe publikimit në faqen e internetit të Orkestrës së Muzikës Xhaz të RMV-së.

Kryetari i Këshillit Drejtues,

Sashko Nikollovski

Kjo Rregullore zbatohet për punësimin e artistëve, me afat të caktuar dhe pa afat, për sistemimin në vende pune, për përcaktimin e aftësisë së praktikantëve për kryerjen e pavarur të detyrave të punës, si dhe për raste të tjera kur paraqitet nevoja për audicion. Kandidatët e paraqitur njoftohen me shkrim (në tabelën e njoftimeve, si dhe në uebfaqen) për ditën dhe vendin e zhvillimit të audicionit.